Numër: 01-474
Datë: 04.08.2023

Këshilli Drejtues i Autoriteti Kombëtar të Kualifikimeve - kanë shqyrtuar ankesën Nr.01/331 të parashtruar me datë 06.06.2023 nga Kolegji "Biznesi" - Prishtinë, kundër vendimit të Këshillit Drejtues të AKK-së Nr.01/276, të datës 19.05.2023, duke vepruar në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe, Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 03.08.2023 nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Kolegji"Biznesi" - Prishtinë Nr.01/331 të parashtruar me datë 06.06.2023.

II. Mbetet në fuqi vendimi Nr.01/276, të datës 19.05.2023 i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.

III. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit.

Arsyetim

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve duke u bazuar në kërkesën e institucionit Kolegji"Biznesi" - Prishtinë validim dhe akreditim të institucionit si dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimeve, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, në mbledhjen e mbajtur me datë 19.05.2023, duke vepruar në përputhje me kompetencat e tij ligjore ka nxjerr vendimin Nr.01/276, me të cilin vendim ka vendosur për akreditimin e institucionit dhe validim të kualifikimit "*Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë*" (niveli V sipas KKK, 9 kredi) për periudhën një (1) vjeçare duke filluar nga data 03.05.2023 deri me 02.05.2024.

Kolegji "Biznesi" i pakënaqur me Vendimin me Nr.01/276, të datës 19.05.2023 të Këshillit Drejtues të AKK-së, bazuar në dispozitat ligjore, me datë 06.06.2023 parashtron ankesën me numër protokolli Nr.01/331 në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve, me pretendimet për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi me të cilat rregullohet kjo fushë dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli Drejtues i AKK-së pasi ka shqyrtuar në parim ankesën dhe pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, ka vendosur që bazuar në Nenin 95 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), të ftoj ankuesin që të realizoni të drejtën për t'u dëgjuar pran Komisionit të Ankesave në AKK. Seanca dëgjimore është mbajtur me datë 19.07.2023.

Administrimi i provave: Këshilli Drejtues i AKK-së për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova:

- Vendimi Nr.01/276, të datës 19.05.2023, i Këshillit Drejtues të AKK-së;
- Ankesën e Kolegji "Biznesi" Nr.01/331 të parashtruar me datë 06.06.2023;
- Komentet për raportin vlerësues për akreditim të Kolegjit "Biznesi", Nr.117/23 datë 16.03.2023;
- Komentet për raportin vlerësues për validim të Kolegjit "Biznesi", Nr.117/23 datë 16.03.2023;
- Përgjigje në draft raport kërkuar nga AKK, të Kolegjit "Biznesi", Nr.118/23 datë 16.03.2023;
- Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve;
- Komentet dhe komunikimet e ekipit të ekspertëve lidhur me ankesën.

Këshilli Drejtues i AKK-së, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga Kolegji "Biznesi" – Prishtinë, është e pabazuar, sepse:

Këshilli Drejtues i AKK-së, shqyrtoi pretendimet ankimore të ankuesit i cili ka parashtruar kundër vendimit Nr.01/276, të datës 19.05.2023.

Pretendimet e dhëna në ankesën e parashtruar nga institucioni Kolegji "Biznesi" – Prishtinë lidhur me shkelje të dispozitave ligjore në fuqi me te cilat rregullohet kjo fushë dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike nuk qëndrojnë dhe janë të pa bazuara, për faktin se vendimi i Këshilli Drejtues i AKK-së Nr.01/276, të datës 19.05.2023 është i bazuar në Raportin e vlerësimit të ekipit të ekspertëve dhe duke ju referuar akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë fushë nuk ka bazë ligjore për të vendosur ndryshe. Raportet e vlerësimit të ekipit të ekspertëve janë profesionale, të njëjtat Këshilli Drejtues i AKK-së i kishte analizuar dhe shqyrtuar me kujdes dhe konform vlerësimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ka vendosur si në dispozitiv të vendimit Nr.01/276, të datës 19.05.2023.

Sa i përketë pretendimit të ankuesit se komentet e institucionit (ankuesit) të dhëna në Draft Raportin e Ekipit të Ekspertëve nuk janë përfshirë në Raportin finale të Ekipit të Ekspertëve, Këshilli Drejtues i AKK-së ka kërkuar sqarime shtesë nga ekipi i ekspertëve, ku më pas ka marr sqarimet e nevojshme në të cilat thuhet se:
"...mund të konstatojmë se të gjitha rekomandimet janë dhënë bazuar në gjendjen faktike dhe dëshmitë e ofruara nga ana e institucionit. Konstatimi se përshkrimi në raste të caktuara është i përgjithshëm qëndron për faktin se ekipi i ekspertëve është munduar të nxjerrë më të mirën gjatë vlerësimit të procesit në bazë të dëshmive të ofruara. Përndryshe, dëshmitë e ofruara nuk kanë qenë mjaftueshëm bindëse që periudha e akreditimit dhe validimit të jetë më e gjatë. Marrë parasysh faktin se ky institucion është për herë të parë në këtë proces, ekipi i ekspertëve ka menduar tu japë një mundësi për periudhë një vjeçare me kusht që gjatë kësaj kohe institucioni të punoj më shumë në mënyrë që të përmirësoj procesin. Konstatimi se raportet janë identike nuk qëndron. Secila kërkesë është përshkruar konform kërkesave të raportit. Megjithatë ka disa raste për kërkesa të njëjta në të dyja raportet dhe do të ishte jo profesionale sikur vlerësimi të bëhej ndryshe, p.sh.
- Rekomandimet për përmirësim të procesit
- Rezultatet e përgjithshme dhe përfundimet, kjo pjesë duhet vlerësuar njëjtë. "

Këshilli Drejtues i AKK-së me saktësi ka ndjekur të gjitha hapat ligjor dhe ka respektuar procedurat e përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime në Kosovë, si dhe bazuar në Rregulloren e punës së Këshillit Drejtues i AKK-së me votat e të gjitha anëtarëve prezent, ka vendosur që pas pranimit të raportit dhe mendimit të ekspertëve vlerësues lidhur me ankesën e institucionit Kolegji "Biznesi", për të njëjtin të votojnë në përputhje me nenin 41 të Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ekspertët vlerësues me kërkesë të Këshillit Drejtues i AKK-së përmes emalit zyrtar kanë dhënë mendimin profesional lidhur me pretendimet ankimore të institucionit Kolegji "Biznesi", ku janë adresuar të gjitha

pretendimet e ankuesit dhe ku paneli i ekspertëve, ri konfirmon edhe njëherë se, mbetet pranë Raportit përfundimtar dhe rekomandimeve përcjellëse të dhënë në raportet e akreditimit dhe validimit për institucionin.
Vlerësimi dhe mendimi përfundimtar i panelit të ekspertëve është mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga ana e institucionit Kolegji "Biznesi", me aplikacion, dokumentet shtesë të dorëzuara sipas afateve të përcaktuara nga AKK dhe në veçanti në të gjeturat dhe konstatimet e nxjerra nga vizita dhe takimet e realizuara në institucion me menaxhmentin dhe stafin e trajnerëve. Paneli i ekspertëve konsideron se të gjitha sqarimet e nevojshme dhe të gjeturat për institucionin në fjalë, janë paraqitur në raportet përfundimtare të akreditimit dhe validimit, të dorëzuara në AKK dhe se në çdo kohë qëndrojnë pranë tyre.

Këshilli Drejtues i AKK-së mbështetur në mendimin e ekspertëve vlerësues të dhënë pas parashtrimit të ankesës së institucionit Kolegji "Biznesi", dispozitat ligjore që rregullojnë fushën specifike, dëgjimit të palës ankuese në seance dëgjimore dhe kompetencat ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi,

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtroj padi në Gjykatën Kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Fillimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi u dërgohet:

- Ankuesit Kolegjit "Biznesi";
- Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim MUSTAFA

Kryetar KD së AKK